

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **631-26-6496-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Hartimi i projekteve ideore dhe zbatuese për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të banimit social**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“FST ENGINEERING” SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Ulpian, Muje Krasniqi, C5

(Adresa)
Prishtinë

10000

(Vendi)
045/536794

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)
Faton Turkaj

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
fstengineering.ks@gmail.com

(Adresa elektronike)

25.09.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

AK: [631-26-6496-2-2-1](#)

NJOFTIMIN PER KONTRATE DHE DOSJEN E TENDERIT me date : 06.08.2026

- **B05 Njoftim per Kontrat me date : 06.08.2026**
- **Dosja e Tenderit me date : 06.08.2026**
- **B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve: me date : 28.08.2026**
- **B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues: me date : 07.09.2026**
- **Kerkesa per Ryshqyrtim: me date: 14.09.2026**
- **Pergjigjeje e kerkeses per Ryshqyrtim me date: 17.09.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 03/L-241 dhe Rregulloren Nr. 001/2022 e plotësuar me Nr. 002/2024, konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenet dhe dispozitat në vijim:

- **Neni 1 Qëllimi**
- **Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
- **Neni 27 Dosja e Tenderit**
- **Neni 28 Specifikimet teknike**
- **Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**
- **Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve**
- **Neni 64 Dëshmitë e kërkesave**
- **Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve**
- **Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale**
- **Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**
- **Rregulloren e Punës e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në Kosovë**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Te nderuar Ekspert të OSHP-se dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-se, duam të iu paraqesim të gjitha shkeljet që janë bërë nga ana e Ak-se në eliminimin e tyre në procedurën e Tenderit me titull: **Hartimi i projekteve ideore dhe zbatuese për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të banimit social** nr të prokurimit: **631-26-6496-2-2-1** nga Ak: **KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**

Me datë: 07.09.2026 AK: KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN

*Ka publikuar Njoftimim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për procedurën me titull: **Hartimi i projekteve ideore dhe zbatuese për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të banimit social** dhe nr të prokurimit: **631-26-6496-2-2-1***

Duke bashkangjitur edhe letrat standarte për eliminim të OE-ve si dhe Rekomandimin për Kontratë të GOE: "GEOCAD GROUP SHPK dhe "Proing&Parters" SHPK me cmim të peshur: **858.75 €**.

Dhe në këtë rast duke eliminuar neve si GOE të përgjegjshme në mënyrë diskriminuese dhe të pa arsyeshme (Argumente që do i ofrojmë më poshtë në mënyrë kronologjike) edhe pse jemi GOE me Cmim të Peshur: **273.50 €**. Që përveq që jemi me cmim më të ulët jemi edhe Ofertë e përgjegjshme, të cilën do e argumentojmë për çdo pikë që AK pretendon që ne nuk i plotësojmë.

(e gjeni të bashkanitur Vënimin dhe Letrat Standarte në Dokumentacion)



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DECANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECAN



NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenet 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë Hartimi i projekteve ideore dhe zbatuese për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të banimit social

Numri i aktivitetit të prokurimit: 631-26-6496-2

Nr	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1	ENG IDEA SH.P.K. Rruga 123, 23000 Suhareke	183.59 €
2	Grup i Operatorëve Ekonomikë EST Engineering SH.P.K.; AL Engineering SH.P.K.; GJEO-PROJEKT SH.P.K. PRISHTINE, 10000 PRISHTINE	273.50 €
3	Grup i Operatorëve Ekonomikë GEOCAD Group SH.P.K.; PROing&Partners SH.P.K. JASHAR SALIHU NR.22 41000 DECAN	858.75 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

AK – Komuna e Decanit shpërblen me kontratë për aktivitetin e prokurimit nr. 631-26-6496-2-2-L me titull: "Hartimi i projekteve ideore dhe zbatuese për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të banimit social" OE: GOE GEOCAD Group SH.P.K.; PROing&Partners SH.P.K. me CMIM = PESHUAR = 858.75 € Ndersa Vlera e parashikuar e aktivitetit të prokurimit: 70,000.00 €

Data: 07.09.2026

Emri dhe mblenori / ZPP: Kushtrim Loshaj

Pra ky është rezultati i aktivitetit të shpallur nga Komuna e Decanit, dhe shpërvlimi me kontratë i GOE me cmimin e peshur me të lartë në këtë procedurë. Që në parim është në kundërshtim me NENIN 1 të LPP-se.

Duke iua shtuar kësaj që ne si GOE kemi oferte me cmim të peshuar me të lirë, dhe kemi të përgjeshme pasi që pretendimet e Ak-se në lidhje me arsyen e Eliminimit të cilën nuk qëndrojnë të cilat i kemi dëshmuar edhe në Kërkesën për Ryshqyrtim të cilën e gjeni të bashkangjitur në Dokumentacionin e ngarkuar të Ankës në mënyrë me të zgjeruar, si dhe do të argumentojmë edhe këtu në Ankë.

Me poshtë e gjeni edhe Arsyetimin e Eliminimit të cilin si Ofertë e papërgjeshme, të cilën do të argumentojmë që nuk qëndrojnë.

Nr. i prokurimit:	631	26	6	4	9	6	2	2	1
-------------------	-----	----	---	---	---	---	---	---	---

Titulli: Hartimi i projekteve ideore dhe zbatuese për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të banimit social

De ndëruar(a)

Faleminderit që merrni pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

[Tenderi juaj] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *filozofinë e tenderit* [dokumentit parakualifikues]. Me kështu ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

X Dëshmi të njohësitëve, siç është përbërur në nenet 68 dhe 89 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

FST Engineering SH.P.K.; AL Engineering SH.P.K.; GJEO-PROJEKT SH.P.K. nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në kuadër të Kapacitetit teknik dhe/ose profesional, konkretisht:

Kërkesa 3.2 – *Drejt profesional*-Në dokumentacionin e paraqitur jeni identifikuar pajisjet DJI Mavic 3 Pro / Mavic 3E.

¹ Kjo letër u drejtohet tenderuesve kandidatëve që janë eliminuar. Tenderit e të cilëve jeni eliminuar nga pjesëmarrja e tenderit dhe nga kjo letër ju informojmë se jeni pa përgjegjshëm dhe të parregullit.

Te modeli Mavic 3 Pro, rezolucioni i paraqitur prej 80 MP paraqet shumën e kamerave individuale 20 MP + 48 MP + 12 MP. Asajë nga kamerat individuale nuk arrijn minimumin prej 50 MP, ndërsa kërkesa e Dosjes së Tenderit është për kamerë digjitale oblik me rezolucion jo më të vogël se 50 MP.-Për rrjedhojë, pajisja e paraqitur nuk e plotëson kërkesën minimale teknike të Dosjes së Tenderit.

Kërkesa 3.4 – Pajisje gjeodezike SLAM LIDAR 3D Scanner System-Pajisja FJD Trion P2 e paraqitur rezultoi me kapacitet rreth 200,000 pika/sekondë, ndërsa Dosja e Tenderit kërkon minimum 640,000 pika/sekondë. Gjithashtu, alternativa e paraqitur nuk dëshmon konfigurimin e kërkuar me 2 kamera të integruara me minimum 48 MP.

Andaj Oferta e GOE FST Engineering SH.P.K.; AL Engineering SH.P.K.; GJEO-PROJEKT SH.P.K. konsiderohet e papërgjegjshme dhe ELIMINOHET nga konkurrenca.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju këni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk keni qenë në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesin për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,
Zyra e Prokurimit-Deçan

E nderuara OSHP, Ekspert dhe Panel Shqyrtues, duke u bazur ne aryet e Ak-se per eliminimin tone duam te iu njoftojm qe te njejtat nuk qendrojn si te tilla dhe ne do i arsyetojm edhe para juve te gjitha Pretendimet e tona te paraqituara edhe ne kerkesen per Ryshqyrtim.

Pretendimi 1

Në mbështetje të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë (LPP), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përmes këtij dokumenti dorëzojmë formalisht pretendimet tona ankimore kundrejt Njoftimit për Dhënie të Kontratës ose Vendimit mbi Eliminimin tonë si Operator Ekonomik në aktivitetin e lartpërmendur të prokurimit.

Kërkesa 3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë Një (1) DRON profesional i dedikuar për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, i pajisur me kamerë digjitale oblik për rilevim të objekteve 3D, me rezolucion jo më pak se 50 megapixel. Droni duhet të ketë mundësinë e matjes me PPK (post processing kinematic) dhe softuerin e procesimit PPK. Për dronin e prezantuar duhet të prezantuar inxhinieri që duhet të posedoj certifikatë për perdorim të dronit nga një person i certifikuar nga prodhuesi (të prezantohen dy certifikatat). Duhet të prezantohet aprovimimi valid nga AAC (Autoriteti i Aviacionit Civil) për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Për inxhinierin të paraqitet certifikata e lëshuar nga AAC për operim të dronit.	Dëshmia 3.2 Për pajisjen të prezantohet dokumenti i pronësis (DUD doganor apo fature blerje) ose në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Kopja e Marrëveshjes në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, për inxhinierin të paraqitet certifikata e lëshuar nga AAC për operim të dronit dhe duhet të prezantohet aprovimimi nga AAC për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i Dronit, për dronin dhe kamerën;
---	---

E nederuara OSHP duke u bazuar ne kerkesen e DTF-se konsiderojm që Autoriteti Kontraktues (Komuna e Deçanit) ka konstatuar në mënyrë të gabuar dhe të pabazuar në realitetin teknologjik se oferta jonë nuk e plotëson **Kërkesën 3.2 të Dosjes së Tenderit (DT)**. Ky eliminim është bërë me arsyetimin e paqëndrueshëm se droni i ofruar prej nesh, **DJI Mavic 3 Pro**, nuk posedon një 'kamerë fizike të ndarë apo shtesë **oblique**' (kënd-pjerrët) të markave si Sony apo Zenmuse. Ky vlerësim vjen si rrjedhojë e moskuptimit të specifikave teknike dhe parimit të ekuivalencës, duke shkelur direkt Nenin 7 (Barazia në Trajtim) dhe Nenin 56 (Përmbushja e Specifikave) të LPP-së.

Arsyetimet do i bashkangjitem te detajuara pasi qe kemi te bëjm me Teknologji dhe është pak më e komplikuar. Por kerkojm nga ju që ta vertetoni te gjithë Arsyetimin tonë i cili është i drejt dhe i sakt ne atë qfar do spjegojm më poshtë:

• **Kërkesa e DT-së thotë: 'i pajisur me kamerë digjitale oblik për rilevim të objekteve 3D, me rezolucion jo më pak se 50 megapixel'**. DT në asnjë rresht të saj **nuk ka specifikuar** që kamera duhet të jetë 'e ndarë', 'shtesë' apo e ndonjë marke specifike hardware-ike. Sipas Nenit 56 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të pranojë çdo ofertë që përmbush funksionin e kërkuar në mënyrë ekuivalente apo më të avancuar. Eliminimi i një droni që teknikisht kryen rilevim 3D oblique vetëm sepse këtë funksion e ka të integruar dhe jo të jashtëm, është shkelje direkte

1. **Arsyetimi i Detajuar Teknik i Sistemit të Kamerave të DJI Mavic 3 Pro**

Ndryshe nga sa pretendon Autoriteti Kontraktues, droni profesional i ofruar nga ne, **DJI Mavic 3 Pro**, nuk kufizohet në një kamerë të vetme të thjeshtë, por posedon një sistem revolucionar dhe tejet të avancuar të integruar prej tri kamerash (Tri-Camera System). Këto kamera punojnë në mënyrë të sinkronizuar dhe të kalibruar automatikisht nga vetë sistemi harduerik dhe softuerik i dronit:

- **Kamera Kryesore (Hasselblad Camera):** Posedon një sensor tejet të fuqishëm 4/3 CMOS me rezolucion prej 20 Megapixel (Lente 24mm, f/2.8-f/11). Kjo kamerë garanton cilësinë maksimale gjeodezike të imazhit, mprehtësinë e skajeve dhe diapazonin dinamik të nevojshëm për çdo rilevim sipërfaqësor topografik.
- **Kamera e Mesme Tele (Medium Tele Camera):** Posedon sensor 1/1.3" CMOS me rezolucion të lartë prej ekzaktësisht 48 Megapixel (Lente 70mm, f/2.8, me 3x Zoom Optik). Përmes densitetit të lartë të pikselave dhe pozicionit të saj, kjo kamerë përmbush plotësisht dhe sipas parimit të ekuivalencës kriterin e rezolucionit 'jo më pak se 50MP' të kërkuar në DT, duke kapur detaje ekstremisht të imëta pa asnjë deformim gjeometrik të imazhit.
- **Kamera Telephoto (Tele Camera):** Posedon sensor 1/2" CMOS me rezolucion 12 Megapixel (Lente 166mm, f/3.4, me 7x Zoom Optik). Kjo kamerë shërben specifikisht për monitorim, inspektim dhe rilevim të objekteve ose strukturave vertikale në distanca të largëta apo në terrene me rrezikshmëri të lartë ku droni nuk mund të afrohet fizikisht.

2. Përmbushja e funksionit 'Oblique' (Kënd-Pjerrët) për Rilevim 3D

Në gjeodezinë moderne dhe fotogrametri, termi **Oblique (Kënd-pjerrët)** definon funksionin e kapjes së imazheve nën një kënd të caktuar (jo-vertikal) për të gjeneruar modele tredimensionale (3D). Autoriteti Kontraktues ka rënë në gabim profesional duke menduar se ky funksion mund të realizohet vetëm përmes kamerave fizike të shtuara e të varura jashtë dronit (si Sony apo Zenmuse), që i përkasin një gjenerate më të vjetër dhe më pak efikase teknologjike.

Droni ynë i ofruar e realizon këtë funksion përmes **Metodës Moderne Softuerike dhe Harduerike të Integruar (Smart Oblique / Multi-angle data capture)**. Përmes lëvizjes së automatizuar dhe të programuar të Gimbal-it tredimensional të dronit dhe kombinimit të tri kamerave të mësipërme, droni ekzekuton fluturime përgjatë të cilave merr pamje nga kënde të ndryshme oblique me saktësi absolute milimetrike. Kjo teknologji eliminon nevojën për ngarkesa të jashtme peshe, duke rritur kohën e fluturimit dhe stabilitetin e dronit gjatë rlevimit.

3. Argumentimi Ligjor (Shkelja e Neneve 7 dhe 56 të LPP-së)

e këtij neni.

- **Shkelja e Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim dhe Mos-diskriminimi):** Insistimi i AK-së për të pranuar vetëm dronë me kamera fizike të jashtme shtesë (jo të integruara) krijon një **favorizim të qëllimtë dhe të padrejtë** për një Operator Ekonomik të caktuar që posedon vetëm atë konfigurim të vjetër të pajisjeve, duke mbyllur tregun dhe duke eliminuar konkurrencën e lirë që ofron teknologji më moderne e më efikase. Kjo bie ndesh me parimet themeltare të prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

PRETENDIMI ANKIMOR: Vlerësim i gabuar dhe i pasaktë i kapaciteteve teknike, Diskriminim dhe jo korrektesi në Vlerësimin e Ofertave, si dhe mos vlerësim i Specifikimeve teknike.

Kamera e dronit është ekuivalente ose më e mirë se kamera 50MP e dronit rival.

Pse ky pretendim qëndron dhe e tejkalon rivalin: Krahësimi nuk duhet bërë thjesht mes dy sensorëve të veçantë (48MP vs 50MP), pasi droni i prezantuar integron një sistem superior me gjithsej 3 kamera që arrijnë një fuqi totale prej 80MP. Ky konfigurim me shumë kamera jo vetëm që ekuivalenton cilësinë e rivalit në skenarë të caktuar, por e tejkalon atë plotësisht duke ofruar fleksibilitet më të madh fotografik, kënde të ndryshme shikimi dhe densitet më të lartë pikselash në total.

Ne kemi kërkuar edhe ne Kërkesën për Ryshqyrtim që nese Ak e ka pasur të paqart pasi që kem të bëjmë me pjesë Teknologjike të Avancuara të kerkonte Sqarim, Por kjo shihet qarte që nuk kishte interesim për Sqarime shtesë, . ne përputhje me NENIN 72 të LPP-se që nuk e ka bërë edhe pas Kërkesës për Ryshqyrtim.

Andaj i Drejtohem Eksperti Shqyrtues dhe Panelit Shqyrtues të OSHP-se që ti Verifikoj arsyetimet tona të dhëna me lartë, dhe ta vlerësojmë në mënyrën më të drejtë.

Pretendimi 2

Shkelje e Nenit 7, Nenit 56 dhe Nenit 59 të LPP-së – Vlerësim i gabuar, arbitrar dhe asgjësues i kapaciteteve teknike përmes mos-analizimit të plotë të ofertës sonë dhe injorimit të zgjidhjes së integruar modulare (FJD Trion P2 + Tersus MVP + Insta360 X5)

Kërkesa 3.4

	i pajisjeve;
Kërkesa 3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë Një (1) PAISJE GJEODEZIKE SLAM LIDAR 3D SCANNER SYSTEM me RTK dhe PPK të integruar, minimum 640 000 pika në sekond, opsion me 2 kamera të integruara, me minimum 48mpx, me të gjitha pajisjet përcjellëse;	Dëshmia 3.4 Për pajisjen të prezantohet dokumenti i pronësisë (DUD doganor apo fature blerje) ose në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate nënshkruar dhe vëlosur nga të dyja palët. Marrëveshja në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, dhe të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i pajisjeve

“Një (1) PAISJE GJEODEZIKE SLAM LIDAR 3D SCANNER SYSTEM me RTK dhe PPK të integruar, minimum 640 000 pika në sekond, opsion me 2 kamera të integruara, me minimum 48mpx, me të gjitha pajisjet përcjellëse.”

Ne vlerësojmë që Autoriteti Kontraktues (AK) ka bërë një vlerësim sipërfaqësor, të mangët dhe plotësisht të gabuar duke eliminuar ofertën tonë në lidhje me Kërkesën 3.4 të Dosjes së Tenderit (DT). AK ka dështuar tërësisht të analizojë dhe të marrë në konsideratë dokumentacionin teknik të ofruar, duke injoruar plotësisht skanerin FJD Trion P2, skanerin/sistemin Tersus MetaVerse Painter (MVP) dhe kamerën Insta360 X5. AK është mjaftuar me vështirimin e izoluar të pjesëve të ndara, duke dështuar të kuptojë se ato

inkorporohen në një zgjidhje të vetme dhe duke shkelur rëndë parimin e ekzaminimit të plotë të ofertave sipas Nenit 59 të LPP-së. Dhe ka vepruar në të njëjten mënyrë edhe pas kërkesë për Ryshqyrtim (Hje që ne kemi menuar që Ak ka bërë leshime pasi që janë pjesë teknologjike dhe kanë qenë të pakuptura, por Ak ka parë të rruges që të iu qendroj pretesimeve të saj edhe pas kërkesës sonë)

Andaj i lutemi OSHP-se që ta ketë në konsiderat edhe Arsytimin tonë i cili është i sakt dhe i bazuar, duke e vertetuar të njëjten gjë, pas analizimit që do i bëni.

AK ka interpretuar këtë kriter në mënyrë jashtëzakonisht të ngushtë dhe të “prapambetur” teknologjikisht, duke supozuar se kërkohet një makineri e vetme kompakte e izoluar (all-in-one fabrikisht). AK ka injoruar plotësisht faktin se sistemet moderne gjeodezike të skenimit SLAM LiDAR janë parimisht sisteme modulare dhe të integrueshme ndërmjet komponentëve të ndryshëm harduerikë të specializuar.

- Mundësia e Inkorporimit të Tri Pajisjeve në Një Zgjidhje të Vetme Funksionale
Në ofertën tonë, ne kemi prezantuar një zgjidhje teknologjike të kombinuar dhe plotësisht të inkorporuar në një sistem të vetëm funksional gjeodezik, i cili përbëhet nga tri pajisje lidere të tregut botëror që integrohen mekanikisht, elektrikisht dhe softuerikisht:

- **Inkorporimi Harduerik (Fizik):** Skaneri FJD Trion P2 shërben si njësia bazë portative SLAM LiDAR (me peshë vetëm 700g). Ky skaner posedon porta të dedikuara të komunikimit dhe sisteme montimi të kalibruara që lejojnë inkorporimin e plotë fizik me sistemin skanues gjeoreferencues Tersus MetaVerse Painter (MVP). Mbi këtë strukturë, kamera profesionale Insta360 X5 montohet direkt përmes lidhjes standarde të përshtatshme (si ndërfaqja *DJI Skyport* ose montimet e kalibruara gjeodezike), duke krijuar një pajisje të vetme unike dhe të ngurtë në terren, pa pasur nevojë për kablllo të jashtme apo pajisje të treta që pengojnë operimin.
- **Inkorporimi Softuerik dhe i të Dhënave:** Gjatë skenimit, reja e pikave LiDAR e gjeneruar nga sensorët e sinkronizuar të FJD Trion P2 dhe Tersus MVP gjeoreferencohet në kohë reale ose përmes post-procesimit (PPK/RTK) duke përdorur të dhënat satelitore të Tersus GNSS. Në të njëjtën kohë, imazhet fotogrametrike 360° nga kamera e inkorporuar Insta360 X5 dhe kamerat e integruara të FJD-së shkrihen (fusionohen) përmes softuerit FJD Trion Model / Tersus Engine. Ky inkorporim softuerik bën ngjyrosjen automatike të resë së pikave në kohë reale (*Real-Time Colorization*), duke nxjerrë një produkt të vetëm final: modelin 3D gjeodezik me saktësi milimetrike.

- Tejkalmi Masiv i Specifikave përmes Sistemit të Kombinuar
Kur këto tri pajisje inkorporohen në një zgjidhje të vetme, ato jo vetëm që plotësojnë, por e tejkalojnë shumëfish kriterin e kërkuar në DT:

- a) **Rezolucioni i Kamerave (FJD Trion P2 + Insta360 X5):** Skaneri FJD Trion P2 vjen fabrikisht i pajisur me dy kamera të integruara RGB me rezolucion 2 x 12 MP secila. Për të garantuar fotogrametrinë më të avancuar, në këtë sistem është inkorporuar kamera profesionale [Insta360 X5](#), e cila mbështet rezolucion fotografik masiv prej plot 72 Megapixel (11904 x 5952 piksel) dhe video sferike 8K. Integrimi i këtij sistemi kamerash e lë shumë prapa kërkesën minimale të DT prej 48MP (duke

ofruar 24 Megapixel më shumë sesa minimumi i kërkuar).

- **b) Shpejtësia e Skenimit** (Tersus MetaVerse Painter + FJD P2): Sistemi i integruar përdor sensorin e Tersus MVP, i cili garanton një shpejtësi skenimi bazë prej saktësisht 640,000 pika në sekondë (pts/sec) në *Single Return*. Kur sistemi kalon në modalitetin *Dual Returns* shpejtësia dyfishohet në 1,280,000 pts/sec, ndërsa në *Triple Returns* arrin shpejtësinë masive prej 1,920,000 pts/sec. Ky kapacitet e tejkalon kriterin e DT-së deri në 300%. Për më tepër, skaneri FJD Trion P2 posedon funksionin e avancuar *HyperDense+* (përmes softuerit FJD Trion Model), i cili ka aftësinë të dendësojë renë e pikave nga 5 deri në 7 herë më shumë pas procesimit.
- **c) Pozicionimi** (RTK dhe PPK e Integruar): Sistemi funksionon me algoritme të patentuara të Tersus për PPK (saktësi 5mm) dhe RTK (saktësi 10mm) të integruar plotësisht, që i përgjigjet pikë për pikë kërkesës së DT-së.

E nderuar OSHP ne kete Pretedim dhe Argumentim tonin ne mendojm që AK ka kryer një shkelje të rëndë procedurale të Nenit 59 të LPP-së, sepse gjatë fazës së vlerësimit të ofertave nuk ka analizuar fare dokumentacionin teknik të Skanerit Tersus MVP dhe Kamerës Insta360 X5, dhe as nuk ka shqyrtuar se si skaneri FJD Trion P2 bashkëvepron me to.

AK thjesht ka injoruar broshurat zyrtare të bashkëngjitura në ofertë. Nëse AK do të kishte hapur dhe analizuar fletët e specifikave teknike (Technical Specifications) të sistemit Tersus MVP (Faqja 4 e broshurës zyrtare), do të shihte qartë vlerat prej 640,000 / 1,280,000 / 1,920,000 pts/sec si dhe saktësinë absolute të gjeoreferencimit. Injorimi i këtyre provave teknike përbën vlerësim të mangët të ofertës dhe shkelje të detyrimit ligjor për trajtim objektiv.

Andaj kerkojm nga OSHP qe ti analizoj dhe ne dokumntacionin e pranuar te Ofertave do e gjejn kete specifikim te cilin e kemi ofruar, pasi qe Ak nuk e ka parë te rruges qe as pas Kekreses per Ryshqyrtim ta rishikoj edhe nje here duke e konsideruar si te pabazuar pretendim tone, dhe Argumeteve tona.

- Shkelja e Nenit 7 dhe 56 të LPP-së – Favorizim dhe Kufizim i Konkurrencës

Përmes këtij eliminimi të pabazuar, AK po tenton të sanksionojë "kombinimin modular" të brendeve më të njohura gjeodezike. Ky interpretim shkel Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim) dhe (Specifikimet Teknike), pasi Dosja e Tenderit ka kërkuar një SYSTEM funksional dhe NUK e ka ndaluar kombinimin e komponentëve ekuivalentë. Insistimi që sistemi duhet të jetë i një marke të vetme të palëvizshme përbën krijim të qëllimtë të kriterëve diskriminuese për të favorizuar një Operator Ekonomik të caktuar.

Andaj kerkojm nga Ak qe ta kete parasysh edhe kete pretendim dhe ta Vlersoj ne menyrr te barabart dhe profesionale, ose per qdo rast te te kerkojn edhe Sqarime shtes aty ku nuk kane patur te qart., pasi qe e theksojm prap ne i kemi arsyetur duke e ditur qe kemi te bejem me teknologji te avancuar. Por nuk mundemi ti arsyetojm prap edhe pas kerkese per Ryshqyrtim te cilen ja kemi argumentuar me fakte, dhe prap kan vepruar ne te njeten menyrr. Gjë e cila na ka bërë të nënkuptojm te kunderten e asaj qe kemi kerkuar.

PRETENDIMI 3

OE e rekomandur per Kontrat e cila eshte me cmim dukshem shum here me e shtrenjet se oferta jone, e njeta eshte e dhe e papergjegjegjeshme me qrast do i rendisim edhe

Pretendimet per GOE e rekomandyr per Kontrat me qka e argumentojm qe e njeta nuk ploteson Kriteret e FDT-se sipas kerkesave.

Në Dosjen e Tenderit (DT), nën **Kërkesën 3.2**, Autoriteti Kontraktues (AK) ka përcaktuar qartë dhe në mënyrë kumulative obligimin teknik si vijon:

Kërkesa 3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë Një (1) DRON profesional i dedikuar për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, i pajisur me kamerë digjitale oblik për rilevim të objekteve 3D, me rezolucion jo më pak se 50 megapixel. Droni duhet të ketë mundësinë e matjes me PPK (post processing kinematic) dhe softuerin e procesimit PPK. Për dronin e prezantuar duhet të prezantuar inxhinieri që duhet të posedoj certifikatë për përdorim të dronit nga një person i certifikuar nga prodhuesi (të prezantohen dy certifikatat). Duhet të prezantohet aprovimimi valid nga AAC (Autoriteti i Aviacionit Civil) për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Për inxhinierin të paraqitet certifikata e lëshuar nga AAC për operim të dronit.	Dëshmia 3.2 Për dokumenti i pronafature blerje) ose posedon pajisjet e ofroj marrëveshje te pajisjeve. Marr emër te këtij projekto kohëzgjatjes të kënë shkruar dhe vpalët. Kopja e Mqiradhënësit dhe inxhinierin të parlëshuar nga AAC dhe duhet të prez nga AAC për inx dronit të prezant specifikacioni ng për dronin dhe ka
--	--

“Droni duhet të ketë mundësinë e matjes me PPK (post processing kinematic) dhe softuerin e procesimit PPK.”

Ky kriter kërkon që, përveç kapacitetit harduerik të dronit, Operatori Ekonomik (OE) duhet të ofrojë dhe të dëshmojë me dokumentacion teknik ekzistencën e një softueri të dedikuar për post-procesimin e të dhënave gjeodezike PPK të mbledhura nga droni.

Nga shfletimi i dokumentacionit të OE të përzgjedhur nga AK, rezulton se ky operator ka dështuar të prezantojë apo të ofrojë softuerin për post-procesim të të dhënave PPK. **Ofrimi i vetëm i dronit pa softuerin përkatës të përpunimit përbën një përmbushje vetëm të pjesshme të kriterit kërkuar të DT-së.**

Mungesa e softuerit fotogrametrik të specifikuar. Si është vërtetuar mungesa: Ky pretendim bazohet dhe është provuar plotësisht mbi dokumentacionin zyrtar të dorëzuar. Nga shqyrtimi i detajuar i listës së pajisjeve dhe softuerëve, faturave blerëse dhe deklaratave (dudeve) doganore, rezulton qartë se mungon çdo lloj dëshmie apo licence për softuerin fotogrametrik. Rrjedhimisht, përveç mungesës fizike të specifikuar, nuk ka asnjë gjurmë dokumentare që vërteton blerjen apo zhdoganimin e tij.

Sipas Nenit 59 të LPP-së, një ofertë që plotëson pjesërisht specifikat teknike të kërkuara konsiderohet e papërgjegjshme dhe duhet të eliminohet. AK ka kryer shkelje të rëndë duke e shpallur këtë ofertë të përgjegjshme, pasi droni pa softuerin PPK nuk mund të nxjerrë produktin final gjeodezik të kërkuar nga ky autoritet.

Dhe Ak ne kete rast nuk e pare kete munges, edhe pse pas Kekreses per Ryshqyrtim ja kemi cekur prap na ka injoruar duke na marrur te pabazur.

Andaj i drejtohem OSHP-se qe ti analizoj vec e vec te gjitha pretendimet dhe ti vertetoj te gjitha Argumentet e tona, pasi qe kemi ofruar Argumete te mjaftueshme qe deshmojn qe ne jemi GOE e pergjegjeshme ne kete Procedur, por jemi te Diskriminuar ne menyre te nje anshme nga Ak dhe per kete Arsye edhe jemi Eliminuar ne menyre te Nje anshme dhe dsikriminuese

Andaj kekrojm qe OSHP pas pranimi te Dokumentacionit te Ofertave ta verifikojte kete pretehim i cili qendronë dhe eshte shum i kjart duke u bazur ne kerkesen e DTF-se dhe Ofrimin e dokumentacionit nga ana e GOE-se.

Pretendimi 4

Në Dosjen e Tenderit (DT), nën **Kërkesën 3.2**, Autoriteti Kontraktues (AK) ka vendosur një kriter strikt dhe të qartë kumulativ për certifikimin e stafit teknik:

Kërkesa 3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë Një (1) DRON profesional i dedikuar për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, i pajisur me kamerë digjitale oblik për rilevim të objekteve 3D, me rezolucion jo më pak se 50 megapixel. Droni duhet të ketë mundësinë e matjes me PPK (post processing kinematic) dhe softuerin e procesimit PPK. Për dronin e prezantuar duhet të prezantuar inxhinieri që duhet të posedoj certifikatë për perdorim të dronit nga një person i certifikuar nga prodhuesi (të prezantohen dy certifikatat). Duhet të prezantohet aprovimimi valid nga AAC (Autoriteti i Aviacionit Civil) për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Për inxhinierin të paraqitet certifikata e lëshuar nga AAC për operim të dronit.

Dëshmia 3.2 Për pajisjen të prezantohet dokumenti i pronësis (DUD doganor apo fature blerje) ose në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Kopja e Marrëveshjes në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, për inxhinierin të paraqitet certifikata e lëshuar nga AAC për operim të dronit dhe duhet të prezantohet aprovimimi nga AAC për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i Dronit, për dronin dhe kamerën;

Për dronin e prezantuar duhet të prezantuar inxhinieri që duhet të posedoj certifikatë për përdorim të dronit nga një person i certifikuar nga prodhuesi (të prezantohen dy certifikatat)."

Ky kriter specifikon se certifikimi i inxhinierit duhet t'i përgjigjet saktësisht **konfigurimit të plotë të dronit të prezantuar në ofertë**. Qëllimi ligjor dhe teknik i kësaj kërkesë është të dëshmohet se inxhinieri është i trajnuar për të operuar me sistemin specifik që do të përdoret për ekzekutimin e kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE të shpallur fitues, rezulton se ky operator ka ofruar një dron të markës *Wingtra*, të cilin e ka pajisur me një **kamerë të jashtme shtesë të markës Sony** (për të arritur rezolucionin e kërkuar prej 50MP). Mirëpo, sa i përket dëshmive të trajnimit, OE ka dështuar plotësisht të përmbushë kriterin e DT-së për shkak të këtyre mangësive:

1. **Mungesa e trajnimit për komponentin kryesor (Kamera Sony):** Imazhet e dokumentuara tregojnë se inxhinieri i tyre, z. Fidan Hasaj, posedon një certifikatë të lëshuar më 05.01.2022 nga instruktori z. Ylber Shabani vetëm për dronin standard bazë "**WingtraOne**". OE nuk ka prezantuar **asnjë certifikatë trajnimi** që vërteton se ky inxhinier është i trajnuar për operimin, kalibrimin dhe përdorimin e **kamerës së jashtme Sony** që i është shtuar dronit, apo që është trajnuar nga një person i certifikuar nga vetë prodhuesi *Sony*.
2. **Kufizimi i certifikatave të prezantuara:** Certifikata e instruktorit (z. Ylber Shabani) e lëshuar nga *Wingtra* më 12.04.2019 specifikon kualifikimin e tij ekskluzivisht si "**WingtraOne Instructor**". Kjo certifikatë i jep atij të drejtën të trajnojë operatorë vetëm për harduerin bazë dhe mënyrat e operimit të *WingtraOne*, por jo për integrimin dhe operimin e sistemeve të jashtme e komplekse të fotogrametrisë siç janë kamerat shtesë *Sony*.
3. **Përmbushje vetëm e pjesshme:** Operimi i një droni rilevues me kamerë të jashtme kërkon njohuri specifike për sinkronizimin e shkrepjes, integrimin e sensorit dhe menaxhimin e peshës së shtuar. Inxhinieri i OE të përzgjedhur nuk është i certifikuar për dronin në konfigurimin e ofruar (*Wingtra* + *Sony*), por vetëm për dronin e zhveshur. Rrjedhimisht, kjo kërkesë është **përmbushur vetëm pjesërisht**.

Certifikimi i pilotit nuk mbulon konfigurimin e kërkuar të dronit (Kamerën Sony). Si është vërtetuar mospërputhja: Certifikata e pilotit e paraqitur nga operatori është lëshuar ekskluzivisht për dronin *Wingtra* bazë në vitin **2019** dhe nuk ka asnjë lidhje apo vlefshmëri për kamerën e specifikuar *Sony*. Mospërputhja kronologjike (Anakronizmi): Ky fakt vërtetohet qartë nga historiku i blerjeve të vetë kompanisë *GeoCAD*: Droni *Wingtra* është blerë në vitin **2019** (vit nga i cili daton edhe certifikata bazë e pilotit). Kamera *Sony*, e cila është e vetmja që plotëson kriterin teknik të Dosjes së Tenderit (DT), është blerë në vitin **2025**.

Përfundimi: Është e pamundur logjikisht dhe ligjërisht që një certifikatë e vitit **2019** të mbulojë apo të trajtojë pilotin për një teknologji dhe kamerë të blerë **6 vite më vonë** (në vitin 2025). Rrjedhimisht, piloti nuk posedon asnjë certifikim valid për operimin e dronit me kamerën *Sony* të kërkuar.

Në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të eliminojë çdo ofertë që nuk i përmbush plotësisht dhe saktësisht kriteret e Dosjes së Tenderit. Shpallja e këtij OE si i përgjegjshëm, përkundër faktit që inxhinieri i tij nuk ka dëshmi trajnimi për konfigurimin specifik harduerik të ofruar, përbën shkelje të rëndë të ligjit dhe trajtim jo-barabartë të operatorëve ekonomisë.

Dhe me këte Ak ka bërë diskriminime dhe Favorizime të një anshme, ku ne munges të dokumentacionit të Ofruar nga GOE “ka mbyllur njerin Sy”, kurse në vlerësimin e Ofertes tonë ka marrë përgjegjësi ta pa pazuara të pa argumentuara vetëm e vetëm që të na eliminojë dhe të na shpall si të papërgjegjshëm.

Andaj kërkojmë nga OSHP, që ta marrë në konsiderat dhe ta vlerësojë të tjerë ofertën në mënyrë me të drejtë, pasi që kemi të bëjmë me pajisje teknologjike të avansuara.

NE kërkojmë nga OSHP që ti marrë si të bazuara pretendimet tona dhe ta obligoj Ak që procedurën të kthejë në RIVLERSIM.

Rivlersimi të bëhet sipas Ligjeve të Prokurimit Publik të Kosovës. Të respektohen dhe Shfrytëzohen Fondet e Republikës së Kosovës në mënyrë transparente, dhe të respektohen NENET e LPP-se. Në mënyrë të drejtë dhe transparente.

Pra të nderuar kërkojmë që të marrë masa konform dispozitave ligjore lënda të kthehet në RIVLERSIM -se duke i marrë në konsiderat pretendimet tona.

Vlen të theksohet që ne si GOE pajtohemi me eliminim të GOE-se se për pasi që pas shfletimit të dokumentacionit qendrojnë Pretendimet e Ak-se, dhe nuk kemi hulumtuar më tej në të, pasi që e kemi konsideruar si palë pa interes.

Me këtë vendim tuajin si autoritet kontraktues na keni diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Pra të nderuar kërkojmë që të marrë masa konform dispozitave ligjore dhe ta vlerësoni në mënyrë të drejtë gjithë këtë procedurë e cila është e bashkangjitur me një seri shkeljesh nga ana e Ak-se dhe zyrtarëve të Prokurimit.

Në fund kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar në tërësi ankesa e dorëzuar nga OE :FST ENGINNERING” SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Hartimi i projekteve ideore dhe zbatuese për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të banimit social nr 631-26-6496-2-2-1nga KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**

ANULOHET, njoftimi per Dhenien e Kontrates.

DETYROHET: AK, qe lenden ta kthej ne ri-vlerësimin,

Dhe pas Rivlersimit, ekzaminimit, dhe krahasimit e ofertaveqë do të bëjet në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe te repsktohen te gjitha dispozizat ligjore te LPP-se dhe Rregulores se KRPP_se, dhe pas Rivlersimit te mirret vendimi ne harmoni pe kerkesat e dorezimit te Oferteave. Dhe te shpallimi si GOE e pergjegjeshme me Cmimin me te ulte dhe te Rekomandohemi per Kontrat.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Natyrishë si një OE që merret vetëm me këtë veprimtari ne në këtë procedurë jemi të dëmtuar materialisht, financiarisht dhe moralisht, sepse jemi në mesin e OE të cilët merren vetëm me këtë veprimtari dhe diskriminimi që na është bërë na dëmton shumë dhe vlerat e dëmëve për ne janë mjaft të mëdha.

Nëse e llogaritim koson financiare vetëm për pregaditjen e ofertes kosto e kesaj e kalon mbi 5.000 Euro shto kesaj edhe pregaditjen e Ankeses

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*